

**SHOQËRIA RAJONALE UJËSJELLËS KANALIZIME KORÇË SH.A.
ZYRTARI I AUTORIZUAR I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

Nr. _____ prot

Datë 02.05.2023

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT 1
(NË PËRFUNDIM TË AFATEVE TË ANKIMIT)**

Drejtuar: "SARK" Sh.p.k , adresa FIER Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier,
Rajoni nr 3, Perball supermarket Lalaj.

Procedura e prokurimit/lotit: **"Procedurë e hapur e thjeshtuar"** me mjete elektronike

Numri i procedurës / referenca e Lotit: **REF-58295-02-07-2023**

Përshkrimi i shkurtër i kontratës [Objekti, sasi dhe kohëzgjatja e kontratës]: **"Asfaltim i rrugës hyrëse të Impjantit të Trajimit të Ujrave të Përdorura (ITUN) pranë Impiantit Fotovoltaik Korçë", me kohëzgjatje 21 ditë kalendarike, duke filluar nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Publikimet e mëparshme (nëse është rasti): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri] :
Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 14 datë 13 Shkurt 2023.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar ne kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim **x**

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

1. "ASI-2A CO" Sh.p.k, NIPT: K53002402C, vlera: 2 322 600
(dymilionetreqindenzetedy mijëegjashtëqind) lekë pa TVSH.
2. "SARK" Sh.p.k, NIPT : K52531415H, vlera: 2 572 500

¹ Ky Formular është i aplikueshëm nëse ka Ankime

(dymilione pesëqindeshatatëdhjetëdymijëepesëqind) lekë pa TVSH.

3. "VASHTEMI" Sh.p.k, NIPT : J64103054Q, vlera: 2 803 290

(dymilionetëqindetremijëedyqindenëntëdhjetë) lekë pa TVSH.

Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar Ofertuesit e mëposhtëm:

1. "ASI-2A CO" Sh.p.k, NIPT: K53002402C.

Për arsyet e mëposhtme:

➤ Për operatorin ekonomik "ASI-2A CO" Sh.p.k, KVO vendosi në mënyrë unanime sa më poshtë vijon:

Në bazë dhe për zbatim të Nenit 26, pika 6 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime, që përcakton se:

"Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat "a", "b", "d", "dh", "e", "h", "i", "j" të pikës 2 të nenit 26, **si dhe** dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin. ",

të Nenit 83, pika 2 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" me ndryshime, që përcakton se, autoriteti kontraktor duhet të publikojë në SPE, njoftimin e fituesit, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pas përfundimit të procedurës së vlerësimit të ofertave,

si dhe të Udhëzimeve të APP Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike,

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me Shkresën Nr. 93/11 prot, datë 24.02.2023, lënda "Njoftim për dorëzim dokumentacioni", i është drejtuar ASI-2A CO Sh.p.k, e ka njoftuar se është kualifikuar i pari, në procedurën REF-58295-02-07-2023 dhe duhet të dorëzojë pranë AK, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin, brenda katër ditëve kalendarike nga njoftimi. Ky njoftim i është dërguar "ASI-2A CO" Sh.p.k, nëpërmjet SPE, nga Kryetari i KVO, në datën 24.02.2023, ora 15:51.

Pas pesë ditësh nga përfundimi i procedurës së vlerësimit të ofertave, në datë 01.03.2023, ora 15:52 KVO ka konstatuar se:

"ASI-2A CO" Sh.p.k nuk ka paraqitur asnjë dokument të shkruar, brenda afatit ligjor, duke mos iu përgjigjur KVO.

Të ndodhur në këto kushte , në mbështetje të Ligjit Nr. 162 dt. 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenit 30, pika 8, KVO ka marrë vendim Nr. 93/12 prot , datë 01.03.2023 për rivlerësimin e procedurës së prokurimit, ka skualifikuar ”ASI-2A CO” Sh.p.k në SPE dhe ka përzgjedhur ofertuesin e renditur i dyti në listën e ofertave të përzgjedhura që kanë mbetur.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë ”SARK” Sh.p.k , adresa FIER Lagjja 8 Shkurti, Rruga Skenderbej, Fier, Rajoni nr 3, Perball supermarket Lalaj, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 2572500 (dymilione pesëqindeshatëdhjetëdymijëepesëqind) lekë është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Shoqërisë Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Korçë Sh.A (UKRK SH.A.), Adresa: Rajoni Nr. 1, Rruga ”Boris Plumbi”, Nr. 20, Korçë, tek Zyra e protokollit, kati i dytë, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pesë ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose nuk dorëzoni sigurimin e kontratës brenda afatit përfundimtar, tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej 2803290 (dymilionetëqindetremijëedyqindënëntë dhjetë) lekë, siç parashikohet në nenin 83 të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Ankesa pas Njoftimit të Fituesit (Paraparak)

PO JO

Nëse Po (vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë:

Vendimi i KPK Nr. 241 prot, datë 03.04.2023, ku KPK ka vendosur:

“- të pranojë ankesën e "SARK" Sh.p.k në procedurën “Procedurë e hapur e thjeshtuar”, REF-58295-02-07-2023, me objekt "Asfaltim i rrugës hyrëse të Impjantit të Trajtimit të Ujrave të Përdorura (ITUN) pranë Impiantit Fotovoltaik Korçë”, me fond limit 2.900.000 (dymilionenëntëqindmijë) leke pa TVSH, të zhvilluar në datën 20.02.2023.

-Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e "SARK" Sh.p.k duke e kualifikuar atë. ”

Në zbatim të Vendimit të KPK Nr. 241 prot, datë 03.04.2023, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave me Vendimin Nr.93/27 prot, datë 12.04.2023 ka kualifikuar "SARK" Sh.p.k nëpërmjet rivlerësimit në SPE.

Ankesa pas Njoftimit të Anullimit të procedurës:

PO JO

Nëse Po (*vendimi përfundimtar për trajtimin e ankesës/ave nr. datë*)_____

Zyrtari i Autorizuar i Autoritetit Kontraktor

Pandi Qirinxhi